



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority



Analiza e tregut të vajit ushqimor në Kosovë

për vitet 2020/2021

Pas shqetësimeve të ngritura nga qytetarët e Republikës së Kosovës se në marketet vendore ka ngritje të çmimit deri në 50% në produktin vaj i lulediellit, duke u mbështetur në Ligjin nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-226 neni ,34, 38 dhe 61, ka filluar monitorimin e këtij tregu.

TREGU RELEVANT

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit- Vaj ushqimorë i përbërë nga fara e lulediellit.

INFORMACIONET E GRUMBULLUARA GJATË SHQYRTIMIT PARAPRAK

-Nxerrja dhe përpunimi i të dhënave të Doganes së Kosovës për produktin Vaj Luledielli

ANALIZA E KONKURENCËS

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka kërkuar nga Dogana e Republikës së Kosovës që të na ofroj të dhënat doganore të importetit të produktit vaj i lulediellit , për t'i analizuar ngritjen dhe uljet e çmimeve hyrese në tregun e Republikës së Kosovës për vitin 2020- 2021, dhe për këtë çështje ka bërë analiza të detajuara bazuar në të dhënat e doganes dhe kemi nxjerr analiza statistikore të variimit të çmimit të importit të vajit, dhe konstatojmë se çmimi importues i vajit dallon nga muaji në muaj. Vërehet qartë se çmimi importues i vajit nga viti 2020 është dukshëm më i ultë se çmimi importues i vajit për vitin 2021.

-Sipas shënimeve të marra nga Dogana e Kosovës, në formë tabeleare keni të paraqitur, çmimet pa Tvsh për produktin Vaj Luledielli dhe sasinë e importuar për vitin 2021-2021:

(Kodi Doganor; 1512199000 - 1512119100)

Viti 2020;

Muajtë	Cmimi total pa tvsh	Sasia/ Liter	Cmimi mesatar
1	1,816,865	2,169,870	0.84
2	1,915,816	2,193,970	0.87
3	2,449,662	2,823,448	0.87
4	2,375,421	2,854,786	0.83
5	1,210,096	1,325,183	0.91
6	1,034,726	1,202,795	0.86
7	1,177,469	1,369,121	0.86
8	1,155,959	1,367,500	0.85
9	1,710,269	1,930,971	0.89

10	2,276,631	2,475,004	0.92
11	2,385,219	2,474,019	0.96
12	2,717,750	2,636,858	1.03
Totali;	22,225,882	24,823,525	0.90

-Çmimi mesatar pa tvsh vitin 2020 ishte; 0.90 cent.

Sic mund ta shihni në tabelë, nuk ka pasur lëvizje drastike të çmimeve përgjatë muajve, dhe as ndryshime të mëdha në sasinë e importuar, ndërsa rritja më e madhe e çmimit është vërenjtur në muajin Dhjetor, ku çmimi ka shkuar në 1.03.

Viti 2021;

Muajtë	Sasia/Liter	Cmimi total pa tvsh	Cmimi mesatar
1	1,074,464.30	1,135,185.46	1.06
2	2,294,627.53	2,461,031.12	1.07
3	1,816,902.25	2,141,761.51	1.18
4	2,630,204.59	3,434,195.29	1.31
5	1,077,418.47	1,393,654.81	1.29
6	1,382,239.54	1,831,078.22	1.32
7	1,479,749.83	1,868,047.54	1.26
8	1,728,224.27	2,140,734.04	1.24
9	2,187,284.13	2,747,298.21	1.26
10	2,952,637.13	3,815,931.92	1.29
11	2,222,739.08	3,151,241.65	1.42
12	2,060,377.62	2,937,171.18	1.43
Totali	22,906,868.74	29,057,330.95	1.27

-Çmimi mesatar pa tvsh për vitin 2021 është; Euro 1.27

Në 2021 kemi ngritje të çmimeve përgjatë muajve, nga 1.06, Euro sa ishte në Janar, çmimi ka shkuar në 1.43 Euro në Nëntor, ndërsa sasia më e madhe e vajit është importuar në muajt Shkurt dhe Tetor.

-Në Kosovë nuk kemi prodhues të këtij produkti dhe i gjithë furnizimi vë nga importi, dhjetë importuesit më të mëdhenj në Kosovë janë: Shih tabelën mbi strukturën e tregut të ndërmarrjeve.

Kompanitë importuese për vitin 2020;

Kompanite importuese	Cmimi total pa t.v.sh	Sasia/ Liter	Cmimi mesatar	Përqindja
(A)	(.....)	(.....)	0.90	(.....)
(B)	(.....)	(.....)	0.93	(.....)
(C)	(.....)	(.....)	0.86	(.....)
(Ç)	(.....)	(.....)	0.98	(.....)
(D)	(.....)	(.....)	0.91	(.....)
(DH)	(.....)	(.....)	0.93	(.....)
(E)	(.....)	(.....)	0.95	(.....)
(Ë)	(.....)	(.....)	0.80	(.....)
(F)	(.....)	(.....)	0.92	(.....)
(G)	(.....)	(.....)	0.96	(.....)
Të tjera	(.....)	(.....)	0.96	(.....)
Totali;	22,225,882	24,823,525	0.90	100%

Kompania A mban pozitë donimuse në tregun e Republikës së Kosovës sa i përket importit të vajit ushqimor. Sipas Indexit Herfindahl-Herschman shkalla e përqendrimit është 1618 që do thotë që ka një përqendrim të moderuar në importit të vajit për vitin 2020, mirpo ky treg mbetet mjaftë konkurrues, dy importuesit më të mëdhenj janë A dhe B.

Kompanitë importuese 2021;


Kompanite	Sasia/Liter	Shuma totale pa tvsh	Përqindja në treg
(A)	(.....)	(.....)	(.....)
(B)	(.....)	(.....)	(.....)
(C)	(.....)	(.....)	(.....)
(Ç)	(.....)	(.....)	(.....)
(D)	(.....)	(.....)	(.....)
(DH)	(.....)	(.....)	(.....)
(E)	(.....)	(.....)	(.....)
(Ë)	(.....)	(.....)	(.....)
(F)	(.....)	(.....)	(.....)
(G)	(.....)	(.....)	(.....)
Të tjera	(.....)	(.....)	(.....)
Totali;	22,906,868.74	29,057,330.95	100%

Ndërsa për vitin 2021 asnjë kompani nuk mbanë pozitë dominuese në tregun e Republikës së Kosovës, sipas Indexit Herfindahl-Herschman shkalla e përqendrimit është nën 1500 që do të thotë që nuk kemi treg të koncentruar.

Top vendet vendet importuese për vitin 2020, për produktin vaj luledielli,

Vendet importuese	Cmimi total pa t.v.sh	Sasia/liter	Cmimi mesatar	Perqindja
Shqiperi	1,077,387	1,072,304	1.00	4%
Bosnje dhe Hercegovina	435,794	452,336	0.96	2%
Bullgari	7,182,077	8,767,353	0.82	35%
Gjermani	2,424,887	2,629,386	0.92	11%
Kroaci	830,698	931,319	0.89	4%
Hungari	546,823	585,144	0.93	2%
Maqedoni	5,239,720	5,562,762	0.94	22%
Slloveni	360,203	391,656	0.92	2%
Turqi	155,276	130,598	1.19	1%
Serbi	3,798,213	4,111,711	0.92	17%
Te tjera	174,804	188,955	0.93	1%
Totali;	22,225,882	24,823,525	0.90	100%


Siq mund ta shihni edhe në tabelë, Kosova importin më të madh e ka me vendet si; Bullgaria ,Maqedonia, Serbia dhe Gjermania. Shih në tabelë sasinë e importuar.



Siq mund ta shihni edhe në tabelë, Kosova importin më të madh e ka me vendet si; Bullgaria ,Maqedonia, Serbia dhe Gjermania.

Top vendet vendet importuese për vitin 2020, për produktin vaj luledielli.

Shtetet	Sasia/Liter	Shuma totale pa tvsh	Cmimi mesatar	Përqindja
Maqedonia	5,550,395.18	7,529,917.72	1.36	24%
Serbia	4,993,883.78	6,330,478.44	1.27	22%
Bullgaria	3,788,853.00	4,617,382.32	1.22	17%
Gjermania	3,078,982.11	3,736,097.79	1.21	13%
Kroacia	1,316,756.79	1,603,536.24	1.22	6%
Bosnja dhe Herzegovina	879,834.16	1,142,404.86	1.30	4%
Hungaria	848,640.00	1,037,708.15	1.22	4%
Sllovenia	929,580.00	991,608.68	1.07	4%
Shqiperia	592,732.00	859,029.19	1.45	3%
Italia	380,191.82	482,420.75	1.27	2%
Te tjera	547,019.90	726,746.81	1.33	2%
Totali;	22,906,868.74	29,057,330.95	1.27	100%



Sikurse edhe në vitin 2020, njëjtë edhe në vitin 2021, importin më të madh Kosova e ka realizur me vendet si; Maqedonia, Serbia dhe Gjermania.

Tregu i Vajit në Evropë.


Evropa dominon tregun e vajit të lulediellit gjatë periudhës së parashikuar 2021-2027. Evropa pritet të mbajë pjesën më të madhe të tregut deri në vitin 2027. Vaji i lulediellit prodhohet kryesisht në Evropë. Globalisht, Ukraina ka vëllimin më të lartë të eksportit të vajit të farës së lulediellit në 2019-2020 në rajonin e Evropës. Vëllimi i eksportit të vajit të farës së lulediellit në Ukrainë ishte 6,686 tonë metrikë në 2019/2020. Në konsumin e vajit të lulediellit është rritur me 2.1% në këtë rajon për shkak të rritjes së kërkesës për një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aplikimeve industriale dhe shtëpiake në shkallë të gjerë. Këta janë faktorët kryesorë që nxisin rritjen e këtij rajoni në tregun global gjatë periudhës së parashikimit 2021-2027.

TOP pesë prodhues të Vajit Ushqimor në botë janë;

Ukrainë, Rusia: Argjentina: Rumania: Kina: Prodhimi botëror i vajit të lulediellit është rritur me 78% në 21.2 milion tonë në dhjetë vjet. Në 2020/2021, liderët e prodhimit të produktit janë Ukraina - 7.1 milion ton (+ 162%) dhe Rusia.

Çmimi në nivel Global i Vajit Ushqimor:

Në vijim do të pasqyrojmë rritjen e Çmimit në Nivel global që është pasqyruar në periudha.



Përfundimi:

- Bazuar në perpunimin e të dhënave doganore konstatohet se A për vitin 2021 mban pozitë dominuese në tregun e importit të vajit ushqimor.
- Çmime e vajit të lulëdiellit janë rritur gradualisht gjatë viteve 2019,2020,2021. Pas hulumtimeve të bëra konstatohet që rritja e çmimit të Vajit Ushqimor, është rritje Globale e cila reflekton në mënyrë zingjyrore edhe në shtetin tonë si importues të këtij produkti.
- Çmimet e vajit të lulëdiellit në tregun botëror kanë ndryshuar ekskluzivisht në varësi të furnizimit dhe kërkesës. Në vitin 2020-2021 shumë prodhues të mëdhenj botërorë, si; Ukraina, Rusia, Bullgaria, Rumania, Moldavia, kishin një rendiment më të keq të lulëdiellit, gjë që ndikoi në mënyrë të pashmangshme në këtë trend të çmimeve në bursat botërore
- 4 .Kryesisht rritja është për shkak të importit nga vendet e tjera. Meqenëse është pandemi COVID-19 dhe bllokim në shumë kombe, importi dhe eksporti hasin në vështirësi që reflektohet, pasi që kostot e transportit dhe paketimet (plastika, kartoni) për të gjitha llojet e mallrave janë **rritur në çmim në mënyrë rekorde**.
- Planifikojmë të zhvillojmë takime me importuesit më të mëdhenjë në Kosovë, për të parë se çka ka ndikuar në këtë rritje, dhe njëkohësisht të përgadisim edhe pyetësorin, me pyetje të cilat derivojnë nga analiza e të dhënave nga dogana.

